

**"FAB GROUP" SHPK
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT L41702005T**

**VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Sot më datë 14.07.2020, ora 11:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Fab Group" sh.p.k të ndodhur në Rruga "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Fab Group" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar më 10/04/2015, me NUIS L41702005T.

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

- Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të Shoqërisë;

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të *Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar)*. Duke qenë se është i pranishëm ortaku që përfaqëson shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Fab Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2019;
2. Dhënien e miratimit për kalimin e fitimit në vlerën 286,815 Lek (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) Lek, në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital;
3. Dhënien e miratimit për Ekspertin Kontabël të Autorizuar, z. Agim Qenani lindur në Korçë, e banues në Elbasan, pajisur me Liçensë Nr.53, për kryerjen e raportit përkatës për rritjen e kapitalit themeltar, nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2019;

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar).

Për sa më sipër:



"FAB GROUP" SHPK
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT L41702005T

ASAMBLEJA E SHOQËRISË

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar z. Agim Qenani lindur në Korçë, e banues në Elbasan, pajisur me Liçensë Nr.53, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Fab Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2019;
2. Të miratojë kalimin e fitimit në vlerën 286,815 Lek (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) Lek, në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2019;
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi të autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për efekt të regjistrimit të tij.


Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:30.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Z.IRFAN HYSENBELLIU

Irfan Hysenbelliu



SHOQËRIA E KUFIZUAR
Sh.p.k.
FAB - GROUP
NIPT: L41702005 T
TIRANË - ALBANIA